



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

PLANI I PUNËS JANAR-DHJETOR 2024

MIRATOI
DREJTORI
Mimoza ÇULIQI

PËRMBAJTJA

1. Qendra e Botimeve për Diasporën

1.1 Misioni

1.2 Vizioni

1.3 Objektivat e përgjithshëm të QBD-së, për periudhën janar-dhjetor 2024

2. Sektori i Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes

2.1 Detyrat kryesore

2.2 Objektivat e përgjithshëm të Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes

2.3 Objektivat e detajuar të Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes

2.4 Plani i veprimtarive të Sektorit të Botimit, Koordinimit dhe Shpërndarjes

3. Sektori i Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve

3.1 Detyrat kryesore

3.2 Objektivat e përgjithshëm të Sektorit të Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve

3.3 Objektivat e detajuar të Sektorit të Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve

3.4 Plani i veprimtarive të Sektorit të Komunikimit, Digjitimit dhe Projekteve

4. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

4.1 Detyrat kryesore

4.2 Objektivat e përgjithshëm të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

4.3 Objektivat e detajuar të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

4.4 Plani i veprimtarive të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Qendra e Botimeve për Diasporën është institucion i krijuar me VKM-në nr. 469, datë 26.07.2018, “*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën*”, të ndryshuar, që financohet nga buxheti i shtetit. Ajo ka qenë në varësi të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe prej vitit 2022 organizohet e funksionon në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

1.1 . MISIONI

Qendra e Botimeve për Diasporën ka për mision:

- Mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe;
- Njohjen dhe përhapjen e kulturës kombëtare në diasporë përmes botimit të teksteve shkollore, botimit të librave me përmbajtje letrare, historike dhe sociale;
- Organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive edukative, kulturore dhe sociale, që kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kulturës amtare në diasporë.

1.2 . VIZIONI

Qendra është në shërbim të misionit të ministrit përgjegjës për arsimin në përfaqësimin dhe nxitjen e politikave të bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët jashtë vendit lidhur me ruajtjen e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare.

1.3 OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM TË QBD-SË, PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024

Qendra e Botimeve për Diasporën synon të arrijë këto objektiva për periudhën janar - dhjetor 2024:

1. Sigurimin e teksteve mësimore për zhvillimin e mësimi të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;
2. Sigurimin e teksteve dhe materialeve plotësuese për zhvillimin e mësimi të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë;
3. Koordinimin e punës së Komisionit e Përbashkët të Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III;
4. Organizimin e trajnimeve për mësuesit e gjuhës shqipe në diasporë;
5. Organizimin e aktiviteteve dhe veprimtarive në ndihmë të përhapjes së gjuhës dhe kulturës amtare në diasporë;
6. Sigurimin e një komunikimi dhe lidhje të vazhdueshme me mësuesit e mësimi plotësues në diasporë.

Programi i punës së Qendrës së Botimeve për Diasporën
Periudha janar - dhjetor 2024

Prioriteti	Objektivat	Aktiviteti	Rezultatet e pritshme	Struktura përgjegjëse
Ruajtja dhe përhapja e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë përmes mbështetjes së mësimit plotësues në shkollat/kurset e gjuhës shqipe në diasporë.	1. Mbështetja e shkollave/kurseve në diasporë me tekste mësimore dhe plotësuese për gjuhën dhe kulturën shqiptare në diasporë.	Bashkërendimi ndërinstitutional me MEPJ-në me qëllim mbledhjen e kërkesave për tekste mësimore të dërguara nga Ambasadat Shqiptare dhe përfaqësitë tona diplomatike në diasporë. Miratimi nga KKB-ja i listës përfundimtare të kërkesave për tekste mësimore. Koordinimi i punës me përfaqësitë jashtë vendit për shpërndarjen e teksteve mësimore në diasporë. Përgatitja e raportit përfundimtar dhe monitorimi i kërkesave për tekste gjatë vitit shkollor.	Pajisja me tekste mësimore për diasporën në vitin shkollor 2024-2025.	QBD, MEPJ, MAS.

	2. Mbështetja e shkollave/kurseve në diasporë përmes hartimit dhe botimit të materialeve plotësuese/ndihmëse për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë	Realizimi i projektit “Jam shqiptar”; Faza II. Projekti i dygjuhësisë: Përkthimi dhe botimi dygjuhësh i vëllimit me poezi të përzgjedhura nga krijimtaria e shkrimtarit Dritëro Agolli në pesë gjuhë: shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht dhe shqip-frëngjisht. Hartimi dhe botimi i revistës letrare dygjuhëshe, shqip-anglisht “Letra nga diaspora” Botime informuese Hartimi dhe përgatitja e revistës informuese “Flasim shqip” për shkollat shqipe në diasporë në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Botimeve për Diasporën.	Pajisja me materiale plotësuese të shkollave dhe bibliotekave në diasporë. Botimi dygjuhësh i veprës së përmbledhur me poezi të Dritëro Agollit. Botimi i nr. 3 dhe 4 të revistës “Letra nga Diaspora”. Botimi i nr. 2,3,4 dhe 5 të revistës “Flasim shqip”.	QBD
--	--	--	--	-----

	3. Rritja e cilësisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë përmes ngritjes profesionale të mësuesve të mësimi plotësues.	Përgatitja e moduleve të trajnimit për mësuesit e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë për tekstin e përbashkët. Organizimi i trajnimeve të mësuesve të gjuhës shqipe në vendet me prani. Itali, Greqi dhe Gjermani. Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme on line.	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë.	QBD, ASCAP
	4. Zgjerimi i rrjetit të shkollave shqipe në diasporë.	Organizmi i takimit vjetor të mësuesve të diasporës “Shqipja në diasporë”, organizuar nga Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në diasporë dhe QBD-së. Pjesëmarrja në grupin e punës për organizimin e seminarit XVII mbarëkombëtar për “Për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë” Mbështetja e aktiviteteve/ seminareve të shkollave shqipe në diasporë. Organizimi i Shkollës Verore të nxënësve të mësimi të gjuhës shqipe në diasporë.	Shkëmbimi i përvojave m.ë të mira; Zgjerimi i bazës së të dhënave të shkollave shqipe në diasporë; Bashkërendimi i punës mes shkollave/kurseve të gjuhës shqipe në diasporë dhe institucioneve shtetërore.	QBD, MAS, MASHTI, ASCAP

Unifikimi i mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë përmes hartimit dhe miratimit të teksteve mësimore të përbashkëta për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.	Përmbyllja e procesit të hartimit dhe miratimit të teksteve mësimore të përbashkëta për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.	Miratimi i kalendarit vjetor të punës të Komisionit të përbashkët Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve mësimore për diasporën, Niveli III. Shpallja e konkursit për tekstin e përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” Niveli III. Përzgjedhja e recensuesve shkencorë për vlerësimin e tekstit të përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” Niveli III. Përmbyllja e konkursit për tekstin e përbashkët “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” Niveli III.	Hartimi i teksteve të përbashkëta të Shqipërisë dhe Kosovës për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë (Niveli I, Niveli II dhe Niveli III) në përputhje me kurrikulën e përbashkët të mësimit plotësues në diasporë dhe mërgatë.	MAS, MASHTI, QBD, ASCAP
---	---	--	---	--